

## JETA SHKENCORE

### ***Tryeza shkencore “Kahe, koncepte dhe metodologji në Semantikën gjuhësore – pikëvështrime të sotme”***

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (ASHSH), më 11 korrik 2024, organizoi *Tryezën shkencore “Kahe, koncepte dhe metodologji në Semantikën gjuhësore – pikëvështrime të sotme”*.

Kjo veprimtari u organizua në kuadër të projektit 3-vjeçar “*Mbi zhvillimet bashkëkohore në fushën e Semantikës gjuhësore – këndvështrime e perspektiva të zhvillimit të dijes në mendimin gjuhësor shqiptar*” (2024-2026), ndërmarrë nga IGJL-ja.

Në këtë tryezë shkencore ishin të pranishëm studiues të fushës së semantikës dhe studiues të fushave të përafërta me këtë dije, të cilët diskutuan rreth prurjeve shkencore në këtë lëmë të dijes gjuhësore, për ndërveprimin e dijeve të kësaj fushe studimi me dije të fushave të përafërta dhe ndikimet e ndërsjella të përfuara si pasojë e natyrës ndërdisiplinare që ka formësuar ndërkohë zhvillimi i kësaj hapësire studimi. Në referime e diskutime u vërejt përpjekja e studiuesve për referenca në koncepte, vepra e autorë përfaqësues të drejtimeve më të suksesshme të fushës së semantikës në etapën e tanishme në shkolla a drejtime të ndryshme gjuhësore, si mbështetje e sigurt metodologjike për studime të suksesshme edhe për gjuhën shqipe.

Në referime e diskutime u vu në dukje gjithashtu që prurjet e shumta shkencore në *Shkencat e ligjërimit* në etapën e tanishme kanë përvijuar një status të veçantë të kësaj disipline mes disiplinave të tjera të *gjuhësisë së gjuhës* dhe një bashkëmarrëdhënie të frytshme me fusha të tjera të studimit, dije e disiplina që përkujdesen për shqyrtimin e dukurive të ndryshme ligjërimore në të ashtuquajturën *gjuhësi e diskursit*. Në këtë kontekst tejet të larmë epistemologjik janë krijuar kahe të veçanta shqyrtimesh brenda dijes së *Semantikës*; ndaj sot po flitet gjithnjë e më shumë për *dije semantike në shumësi shfaqjesh e shqyrtimesh*, ku po mbizotërojnë një shumësi teorish e metodash, konceptesh e pikëvështrimesh, të cilat shqyrtojnë tri profilet më të dukshme të një objekti kompleks në tri qasje kryesore shqyrtimi: *Semantika leksikore*, *Semantika gramatikore* dhe *Semantika diskursive*. E krahas këtyre qasjeve, si plotësuese të tyre, janë në zhvillim e sipër edhe dy të tjera që kanë të

bëjnë me *fjalëformimin* dhe *elementet mbisegmentore (intonacionore)*, që luajnë rol të dukshëm, po ashtu, në ngjizjen e domethënieve dhe kuptimit.

Larmia e çështjeve të lidhura me përfitimën e kuptimit dhe nivelet e ndryshme të analizës në fushën e *Semantikës* u sollën në tryezë të grupuara në dy seanca.

Në seancën e parë, kumtuesit e diskutuesit, duke marrë nxitje nga prurjet e përvojave të shkollave e drejtimeve të ndryshme europiane e atlantike në fushën e semantikës, u përqendruan përgjithësisht në ndonjërin prej hullive të përvijuara tashmë në to, por duke trajtuar a mbajtur parasysh çështje konkrete të lidhura me shqipen. Ndërsa në seancën e dytë, në kumtesat dhe diskutimet e pjesëmarrësve përgjithësisht u synua të trajtohen probleme teorike apo të përcaktohen pozicionime nga një pikëvështrim *përtej* këtyre hullive a rrjedhave konkrete, duke u përpjekur të vëzhgohet hapësira e konfiguruar e një dijeje shumëprofilëshe.

Kumtimet e Artur Lamës dhe Valter Memishës që hapën punimet e tryezës, u përqendruan kryesisht në problematikën e *semantikës leksikore*, në çështje konkrete të saj, por me mëtimin e mbështetjes në interpretime në prurjet e shkollave gjuhësore europiane e më gjerë.

A. Lama, në kumtesën e tij të titulluar “Arritje dhe prirje të veçanta në studimin e dukurive semantike të shqipes”, u përqendrua sidomos në përvojën shqiptare që jo thjesht ka shfrytëzuar modelet e ndryshme të shqyrtimit të dukurive semantike të përvijuara nga kahe të ndryshme të mendimit gjuhësor europian, por ka përfutur tashmë edhe një model me profile të dallueshme, që nxjerrin në pah veçantitë e shqipes në lidhje me dukuritë e natyrave të ndryshme semantike.

I lidhur me probleme konkrete të *semantikës leksikore* në shqipe qe edhe kumtimi i studiuesit Valter Memisha, në kumtesën “Relacionet semantike në një fjalor shpjegues”. Parashtrimet e natyrës teorike të mbështetura kryesisht në prurjet e sotme të shkollës anglo-saksone u bënë në funksion të nxjerrjes në pah të disa dukurive të ngjizjes së kuptimit dhe pasqyrimin të tyre në fjalorin shpjegues të shqipes.

Kumtimet e Rami Memushajt, Albana Dedës dhe Anila Kananajt ishin konceptuar duke mbajtur parasysh lëndën e shqipes, por nga një qasje tjetër: nga ajo e *semantikës gramatikore*. Kumtimet e tyre u përqendruan në probleme të natyrës kuptimore në dukuritë e natyrave të ndryshme gramatikore.

Duke e vendosur trajtesën e tij në një kontekst teorik që nxirrte në pah prurjet e semantikës “dje dhe sot”, R. Memushaj u përqendrua në disa qasje që marrin nxitje nga semantika gjenerativiste, por që kërkojnë trajtim të kujdesshëm teorik në lidhje me veçantitë e shqipes.

I përqendruar në dukuritë e natyrës së *semantikës gramatikore* qe edhe kumtimi i Albana Dedës, “Mungesa e aplikimit të kriterit semantik në Gramatikën I”, në të cilin studiuesja u përkujdes të argumentojë nevojën e

zbatimit të kriterit semantik edhe në shqyrtimin e dukurive të ndryshme gramatikore.

Kumtimin e saj “Metafora në konstruktet e strukturës argumentore“ Anila Kananaj e mbështeti në një qasje të integruar të teorive të gramatikës konjitive, të gramatikës konstruktiviste e të teorisë së Frame Semantics.

Ndërsa Evalda Paci, në kumtesën e saj të titulluar “Në një sprovë të evidentimit të leksikut të sakrales e të flijimit në shqipërimet e klasikëve latinë në gjuhën shqipe” iu qas problematikës së tryezës përmes pikëvështrimit ndërdisiplinor që mundësojnë njohuritë e konceptet e përpunuara në fusha të tilla studimi, si *semantika*, *filologjia* dhe *përkthimtaria*.

Në kumtesën e tij të titulluar “Cilat çështje të semantikës përbëjnë çështje të semantikës gramatikore?”, që hapi seancën e dytë të Tryezës, Leonard Dauti synoi parashtrimin e disa çështjeve të lidhura me *semantikën gramatikore*, mënyrën se si duhet përshkruar ngarkesa semantike që bart dukuria gramatikore; se si ngjizet kuptimi te konstruktet përkatëse gramatikore etj.

Me përpjekjen për të gërshetuar dije ndërdisiplinore të fushës së *semantikës* me ato të *antropologjisë kulturore* dhe *etnolinguistikës* ishte ndërtuar edhe diskutimi i Ledi Shamkut, i titulluar “Kuptimi e domethënia mes funksionalizmit e variacionizmit”.

Përpjekje për ta zgjeruar hapësirën e shqyrtimit të dukurive semantike edhe me prurjet e kaheve a disiplinave të tjera gjuhësore qenë edhe kumtesat e Rafaela Martetës dhe Ardita Dylgjerit, të cilat ngulmuan me prurjet e tyre nevojën për të operuar në shqyrtime edhe me koncepte të përvijuara në *psikologjinë e ligjërimit*, *psikolinguistikë* (R. Marteta), a *pragmatikën gjuhësore* dhe *analizën e diskursit* (A. Dylgjeri). R. Marteta ngulmoi në perspektivën konjitiviste të trajtimit të risive që shfaqen në ligjërimit në etapën e tanishme të zhvillimit të shqipes. Ndërsa A. Dylgjeri u përqendrua në përparësitë që ofron në shqyrtim në fushën e semantikës “teoria e prototipeve”.

Këtë qasje ndërdisiplinore të semantikës me *sintaksën* dhe *pragmatikën* shfrytëzoi edhe Resul Telhai për të parashtruar një sërë çështjesh që lidhen me një hapësirë të veçantë të sintaksës së shqipes që ka të bëjë me tipat kumtuesorë të fjalive, që është njëherazi edhe një çështje semantike dhe pragmatike.

Përpjekje për të vështruar dukuritë leksikore për nga veçantitë semantike që ato shfaqin në procesin përdorimor të gjuhës shënonin edhe kumtesat e Irda Dervishi Nesimit, me kumtesën e saj “Dukuri fjalëformuese në leksikon e gjuhës së shkruar të sotme shqipe” dhe Edona Jahiut, me kumtesën “Zgjerimi semantik brendakontekstor i fjalëve me përdorim të shpeshtë”.

Kumtesa e fundit e seancës së dytë që ajo e Tomorr Plangaricës, e titulluar “Semantika diskursive dhe natyra shumëpërmasore e ngjizjes së kuptimit”, në të cilën u theksua nevoja e zgjerimit të hapësirës së shqyrtimeve përtej interesimeve për shqyrtimin e njësive të sistemit dhe nevoja për përvijimin e së

ashtuquajturës “gjuhësi e diskursit”, pjesë përbërëse e së cilës mund të jetë edhe *semantika diskursive*.

Në fjalën e mbylljes së mbajtur nga T. Plangarica u theksua në mënyrë të veçantë se materialet e referuara në këtë tryezë do të jenë një mundësi më shumë për organizimin e *lektoriumeve* në periudhën në vijim. Në këto lektoriume pjesëmarrësit në projekt, sipas interesimeve të tyre më të drejtpërdrejta, do të kenë mundësinë të trajtojnë dhe diskutojnë tezat e tyre, në një kohë të mjaftueshme për referim dhe në dialog me studiuesit e tjerë.

**Tomorr PLANGARICA**